

VENDIM
Nr.123, datë 24.10.2008

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË FUNKSIONIMIT TË RRJETIT (KODIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE)**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “i”, 9 dhe 55 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, pika 7, si dhe shtojca E, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.53, datë 23.5.2008 “Për fillimin e procedurave për disa ndryshime në kodin e funksionimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, kodin e sistemit të transmetimit, dhe kodin e matjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.10.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e kodit të funksionimit të rrjetit (kodit të transmetimit të energjisë elektrike) të përgatitur nga ana e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e kodit të funksionimit të rrjetit (kodit të transmetimit të energjisë elektrike) (kodi bashkëlidhur këtij vendimi).
 2. Shfuqizimin e vendimit nr.58, datë 28.12.2004 “Për miratimin e kodit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (kodi i funksionimit të rrjetit të transmetimit)”.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta